



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Prijmjen/Prudato Received / Delivary	26	10	2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Bri Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
SKIMSTEK	6478	2022	117		



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.775/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.755/2022 të datës 07.09.2022 të parashtruar nga ankuesja nga më adresë banimi kundër Vendimit me numër protokolli 119 të datës 10.08.2022 të Komisionit Vlerësues të Shërbimit Sprovës të Kosovës në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 26.10.2022, një zëri, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.775/2022 e datës 07.09.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 119 i datës 10.08.2022 i Komisionit Vlerësues të Shërbimit Sprovues të Kosovës dhe Akt-Njoftimi me numër protokolli 116 i datës 29.07.2022 i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Shërbimit Sprovues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 07.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5197/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, e plotësuar më datë 21.09.2022, kundër Vendimit me numër protokolli 119 të datës 10.08.2022 të Komisionit Vlerësues lidhur me Konkursin ngritje (avancim) në detyre me numër referencë RN00009138 për pozitën e punës "Udhëheqës i Zyrës Rajonale në Ferizaj", për shkak të aplikimit jo të drejtë të dispozitave ligjore dhe administrative dhe vërtetimit jo të drejtë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 12.09.2022 ka

proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Shërbimin Sprovues të Kosovës. Ndërsa Këshilli, me datë 16.09.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku më shkresat ndërlidhur me çështjen ankimore në vendosje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova; Ankesën me numër të protokollit 5197/2022 të datës 07.09.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Plotësimin e ankesës të datës 21.09.2022 të parashtruar nga ankuesja përmes emalit me numër të protokollit 5586/2022 së bashku me provat e bashkangjiturà lidhur me ankuesen si Akt emërimit e datës 02.02.2015; Vërtetimin mbi marrëdhënien e punës me numër 99 të datës 22.06.2022; Emalin e datës 16.09.2022 të

drejtuar Emalin e datës 15.09.2022 të Thesarit të Kosovës drejtua Emalin e datës 20.09.2022 të drejtuar Konkursin me numër të referencës RN00009138 të datës 06.6.2022; Ankesën e datës 04.08.2022 të parashtruar nga ankuesja tek Komisioni Vlerësues në Shërbimin Sprovës të Kosovës; Mesazhet telefonike të datës 26.07.2022; Referencën lidhur me përvojën e punës së ankueses në pozitën U.D të Drejtorisë Regjionale në Gjilan; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Përkrahje në sistemin e Drejtësisë për të mitur në Kosovë "; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit të datës 26.11.2004; Diplomën universitare me numër 320 të datës 10.03.2004; Certifikatën e datës 16.12.2021 lidhur me përfundimin e trajnimit Microsoft Windows 10, Microsoft Office Word, Microsoft Office Excel, Microsoft Office Power Point, dhe Microsoft Office Outlook; Certifikatën e datës 03.02.2004 lidhur me përfundimin me sukses të kursit të teknologjisë informative; Certifikatën e datës 28.06.2007 lidhur me përfundimin e Kursit të gjuhës angleze; Certifikatën e datës 25.02.2004 lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze; Certifikatën e datës 03-04.12.2014 lidhur me përfundimin me sukses të trajnimit "Communication Skills"; Certifikatën e datës 11-13.06.2019 lidhur me përfundimin me sukses të trajnimit "Further Strengthening the Correctional and Probation Services in Kosovo"; Certifikatën për pjesëmarrjen në trajnimin "Intervistimi i fëmijëve në konflikt me ligjin" për periudhën kohore 30.09-02.10.2010; Certifikatën për pjesëmarrjen e trajnimit "Keeping Children Safe toolkit" për periudhën kohore, 14, 15, dhe 16.06.2011; Certifikatën e datës 22-23.10.2016 për pjesëmarrjen në trajnimin "Marrëveshja e Stabilizim Asocimit mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian; Certifikatën e darës 10-11.06.2015 lidhur me përfundimin e trajnimit "Motivation Intervieë"; Certifikatën e datës 12-12.02.2015 lidhur me përfundimin e trajnimit "Probation Officer Skill Training"; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit " Probation Service Officers on Risk Assessment" me datën 06-06.04.2011; Certifikatën lidhur me përfundimin me suksese të Kursit "Ngritja e aftësive në lëmin e punës sociale"; Certifikatën lidhur me përfundimin trajnimit "Rehabilitation and Reintegration Programmes in Kosovo" me datën 11-12.03.2015; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Rehabilitation Programmes in Kosovo" me datën 17-19.11.2015; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Rehabilitation Programmes in Kosovo" me datën 25-28.01.2016; Emailin e datës 27.07.2022 të drejtuar Emalin e datës 29.06.2022 të SIMBNJ-se drejtuar Emailin e datës 29.06.2022 të SIMBNJ-se drejtuar Njoftimin me numër të protokollit 116 të datës 29.07.2022 për kandidatin e suksesshme; Emalin e datës 29.06.2022 të SIMBNJ-se drejtuar Emalin e datës 24.06.2022 të SIMBNJ-se drejtuar Emalin e datës 04.07.2022 të SIMBNJ-se drejtuar Emalin e datës 04.06.2022 të drejtuar Njoftimin me numër 107 të datës 4.07.2022 lidhur me kandidatet që kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak; Emalin e datës 13.06.2022 të SIMBNJ-se drejtuar Emalin e datës 21.06.2022 të drejtuar Emalin e datës 22.06.2022 të drejtuar

Emalin e datës 26.06.2022 të drejtuar Formularin për Vlerësimet e Rezultateve të Punës të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategoritë Drejtues i Mesëm, i Ulet dhe Profesional të datës 31.01.2022; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 11.12.2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 5306/2022 të datës 12.09.2022 ; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 5464/2022 të datës 16.09.2022; Vendimin me numër 114/2022 të datës 15.07.2022 lidhur me emërimin e Komisionit Përzgjedhës në Shërbim Civil; Njoftimin me numër protokollit 112 të datës 12.07.2022 lidhur me fazën e verifikimit paraprak; Njoftimin me numër protokollit 107 të datës 04.07.2022 të Burimeve Njerëzore lidhur me kandidatet të cilët i plotësojnë kushtet për ngritje në pozita; Emalin e datës 22.07.2022 të drejtuar

Emalin e datës 21.07.2022 te drejtuar Emalin e datës 21.07.2022 te drejtuar Emalin e datës 27.07.2022 të drejtuar Renditjen përfundimtare të kandidateve të datës 01.08.2022; Listën me numër të referencës RN00009138 të kandidateve të aprovuar dhe të refuzuar; Njoftimin me numër protokollit 116 të datës 29.07.2022 për kandidatin e suksesshëm; emalin e datës 25.07.2022 të drejtuar Emalin e datës 22.07.2022 të drejtuar Emalin e datës 18.07.2022 drejtuar Emalin e datës 18.07.2022 te drejtuar Emalin e datës 18.07.2022 të drejtuar

Tabelën lidhur me vlerësimin e testit me shkrim, intervistës me gojë dhe biografisë; Dosja e kandidatës Aplikacionin me numër të referencës RN00009138 të datës 23.06.2022; Dokumentin e identifikimit; Akt emërimin e datës 01.08.2012; Vendimin me numër 1916 të datës 02.02.2021; Formularin për Vlerësimin e rezultateve të Punës të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i Ulet dhe Profesional të datës 31.01.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 12.01.2021; Vërtetimin për marrëdhënien punës me numër 98 të datës 22.06.2022; Letër konfirmimin me numër Ref.3978/2018 të datës 30.10.2018; Diplomën me numër 12-7/8 të datës 15.09.2004 me të cilën dëshmohet se kandidatja ka përfunduar studimet Magjistër i Psikologjisë; Diplomën me Nr.567 të datës 12.09.2005 lidhur me përfundimin e studimeve bachelor; Certifikatën e Licencimit me numër 361/16 e datës 28.03.2016; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit në Mars të vitit 2022; Certifikatën për pjesëmarrjen në trajnimin "aftësimi për hartimin e strategjive, monitorimi dhe vlerësimi i tyre i mbajtur me datën 04-05.03.2021; Certifikatën e datës 29.10.2020; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Further Strengthening the Correctional and Probation Services in -Kosovo" të mbajtur me datën 07-10.10.2019; Certifikatën lidhur me trajnimin "Further Strengthening the Correctional and Probation Services in Kosovo" të mbajtur në periudhën kohore 05-06 dhe 7 .03.2019; Certifikatën e datës 30.01.2019 lidhur me përfundimin me sukses tre trajnimit Further Strengthening the Correctional and Probation Services in Kosovo"; Certifikatën lidhur me përfundimin me sukses të trajnimit "Further Strengthening the Correctional and Probation Services in Kosovo" të mbajtur me datën 17-18.10.2018; Certifikatën lidhur me përfundimin me sukses të trajnimit "Further Strengthening the Correctional and Probation Services in Kosovo" të mbajtur me datën 22.05.2018 deri me datën 20.01.2018; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit " Rehabilitation Programmes in Kosovo" të mbajtur më datën 17-19.11.2015 deri me 09-10.12.2015; Certifikatën e datës 24.03.2006 lidhur me përfundimin e trajnimit dy javore për Shërbimin Korrektues të Kosovës; Certifikatën e datës 01-03.12.2009 lidhur me pjesëmarrjen e trajnimit "Intervistimi i Fëmijëve në Konflikt me Ligjin"; Certifikatën e datës 11.06.2010 lidhur me përfundimin e trajnimit "Përkrahje Sistemi të Drejtësisë për të Mitur në Kosovë"; Certifikatën lidhur me përfundimin e kursit "Trafikimi i qenieve Njerëzore në roli i Ministrisë së Drejtësisë në parandalim, asistencë direkte dhe mbrojtje të viktimave të trafikimit; Certifikatën e datës 05-06.04.2011 Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Probation Officer Skill Training" të mbajtur me datën 10-11.02.2015;

Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Rehabilitation Programmes in Kosovo" të mbajtur më datën 09-12.11.2015; Dosjen e ankueses; Aplikacionin me numër reference RN00009138 të datës 24.06.2022; Dokumentin e identifikimit: Akt Emërimit të datës 02.02.2015; Akt emërimit të datës 01.08.2012; Dosjen e kandidatës Aplikacionin me numër reference RN00009138 të datës 30.06.2022; Dokumentin e identifikimit; akt emërimit të datës 24.04.2014; Kontratën e punës të datës 25.04.2013; Vërtetimin e lëshuar nga Shkolla e Avancuar e Gjuhës Angleze në Ferizaj, me të cilën dëshmohet se kandidatja ka qenë në marrëdhënie pune të rregullt si psikologe nga data 01.01.2011 deri me datën 24.04.2013; Vërtetimin lidhur me përfundimin e praktikës profesionale të Shëndetit Mendor në Ferizaj në kohëzgjatje 18.04.2011 deri me datën 16.05.2011; Letër Rekomandimit të lëshuar nga Shkolla e Avancuar e gjuhës Angleze; Formularin e Vlerësimit të rezultateve në punë të datës 01.12.2020; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civile, dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtuese të Mesëm, të Ulet dhe Profesional të datës 31.01.2022; Vërtetimin për marrëdhënien e punës me numër 105 të datës 30.06.2022; Diplomën për përfundimin të shkollës së lartë Gjinnazit; Diplomën me numër Nr.1592 të datës 23.03.2011 me të cilën kandidatja mori titullin Bachelor i Psikologjisë; Diplomën me numër 001223 të datës 15.10.2015 me të cilën dëshmohet se kandidatja ka kryer studimet Master në Psikologji; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Menaxhimi i rasteve dhe bashkëpunimi ndër sektorial për mbrojtjen e fëmijëve në konflikt me ligjin nën moshën e përgjegjësisë penale" të mbajtur me datën 28 dhe 29.01.2021; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit Method Supporter and Trainer of Trainers të mbajtur me 01-03.10.2019; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Further Strengthening the Correctional and Probation Services in Kosovo" të mbajtur me 06-07.03.2019 01-04.04.2019 07-10.05.2019 dhe 04-05.09.2019; Certifikatën e datës 30.01.2019 lidhur me përfundimin e trajnimit Further Strengthening the Correctional and Probation Services in Kosovo"; Certifikatën lidhur me trajnimin "Zbatimi i Kurrikules së trajnimeve profesionale bazuar në rezultate" të mbajtur 05-06.06.2018; Certifikatën e datës 21.11.2017 lidhur me pjesëmarrjen në Konferencë "Trauma dhe Atashimi"; Certifikatën me numër reference 6778 të datës 18.06.2016; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin Krijimi dhe Riorganizimi i Strukturave Organizative të Institucioneve" të mbajtur me 12-13.04.2016; Certifikatën lidhur me trajnimin "Rehabilitation Programmes in Kosovo" të mbajtur me datën 14-17.12.2015; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin "Parandalimin dhe Zgjedhja e Konfliktit të Interesit në Administratën Publike" të mbajtur me datën 07-08-2017; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Motivational Interviewing" të mbajtur me datën 10-11.06.2015; Certifikatën e datës 15.06.2003 lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Eorkshoop for Psychologists on Returnee Children" të datës 17.10.2015; Diplomën lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze për periudhën kohore 23.01.2010 deri me 17.06.2010; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Probation Officer Skill Training" të mbajtur me datën 12-13.02.2015; Certifikatën lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze për periudhën kohore 15.10.2010 deri me datën 10.03.2011; Emailin e datës 18.10.2022 me numër të protokollit 6280/2022 të drejtuar KPMSHCK-se; Emailin e datës 01.10.2022 të KPMSHCK-se drejtuar Vlerësimet e Komisionit të Vlerësimit për ankuesen dhe kandidaten e përzgjedhur.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave pasi ka shqyrtuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat e të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankueses është e pabazuar, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se Shërbimi Sprovues i Kosovës më datë 06.06.2022 ka shpallur Konkursin ngritje (avancim) në detyrë me numër reference RN00009138 për

pozitën e punës “ Udhëheqës i Zyrës Regjionale në Ferizaj” klasa Drejtues i Ulet 2, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja duke u përfshirë në të gjitha fazat e konkurrimit, mirëpo që e njëjta bazuar në Renditjen Përfundimtare të Vlerësimit të Komisionit Vlerësues të datës 01.08.2022 është vlerësuar me gjithsej 79.66 pikë duke u renditur si kandidatja e dytë.

Bazuar në Renditjen Përfundimtarë të Kandidatëve, Zyra e Burimeve Njerëzore të Shërbimit Sprovues të Kosovës me datë 29.07.2022 ka shpallur njoftimin për kandidatin e suksesshëm, rrjedhimisht sipas këtij njoftimi kandidatja është shpallur si konkandidate fituese lidhur me pozitën Udhëheqës i Zyrës Regjionale në Ferizaj e shpallur sipas Konkursit ngritje në detyre më numër reference RN00009138.

Ankuesja kundër Njoftimit për kandidatin e suksesshëm, ka parashtruar ankesë fillimisht pranë Komisionit Vlerësues në Shërbimin Sprovues të Kosovës, ndërsa ky i fundit më datë 10.08.2022, me Vendimin më numër protokolli 119 ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar.

Në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesja pretendon së Komisioni Vlerësues me Vendimin numër 119 të datës 10.08.2022 nuk ka aplikuar drejt dispozitat ligjore dhe administrative, nuk ka vërtetuar drejt gjendjen faktike apo nëse nga faktet e vërtetuara është nxjerr konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike. Me tej thekson se vendimi i kundërshtuar me ankesë nuk ka arsyetim të qartë, Komisioni i Vlerësimit ka qenë në kundërshtim të dispozitat ligjore, kandidatet nuk janë njoftuar lidhur me rezultate e çdo fazë të vlerësimit në mënyrë që mund të ushtrojnë ankesë në çdo fazë të vlerësimit, ka pas shtyrje të kohës për testimin me shkrim, vlerësimi i jetëshkrimit dhe intervistës me gojë nuk është profesional dhe etik. Kërkon që Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloj Vendimin me numër protokolli 119 të datës 10.08.2022 të Komisionit të Vlerësimit, të detyroj Ministrinë e Drejtësisë-Shërbimin Sporvues që ankuesen të shpall konkandidate fituese lidhur me pozitën “ Udhës i Zyrës Regjionale ne Ferizaj” ose çështjen ta kthej në rivlerësim duke anuluar konkursin në tërësi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore ka analizuar Konkursin ngritje (avancim) në detyre me numër reference RN00009138 për pozitën “ Udhëheqës i Zyrës Regjionale 1” Drejtues i Ulet 2” i shpallur nga Shërbimi Sprovues i Kosovë me datë 06.06.2022 dhe rrjedhimisht ka gjetur se si kritere të përgjithshme formale janë përcaktuar: *Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare në shkencat shoqërore, fakulteti (juridik, psikologji, sociologji dhe pedagogji) me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to, ndërsa në kualifikim të përvojës së punës; është kërkuar se paku pesë (5) vite përvojë pune në pozitën e një kategorie me të ulet.*

Në kuptim të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji ka analizuar dispozitat ligjore lidhur me procedurën e ngritjes në detyre, përkatësisht :

Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë- Neni 39 me të cilin është përcaktuar se: “ Nëse një pozitë e lirë e kategorisë së ulët apo e mesme drejtuese nuk është plotësuar sipas nenit 38 të këtij ligji, ajo hapet për procedurën e ngritjes në detyrë. 2. Mund të aplikojnë për ngritje në detyrë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, vetëm nëpunësit civilë të një kategorie më të ulët, në marrëdhënie pune në të njëjtin apo në çdo institucion tjetër të Shërbimit Civil, nëse plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë. Në procedurën e ngritjes në detyrë në kategorinë e ulët drejtuese mund të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të kategorisë profesionale të konfirmuar sipas nenit 37 të këtij ligji. 3. Ngritja në detyrë realizohet nëpërmjet një procedure konkurruese të organizuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit, që ka pozitën e lirë. 4. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë nen, për procedurën e ngritjes në detyrë zbatohen dispozitat e paragrafëve 4 deri 9 të nenit 34 të këtij ligji...”

Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës- respektivisht nenin 52 ku thuhet se: *"..2. Ngritja në detyrë është procedurë konkurruese. Konkurrimi organizohet për një pozitë të lirë. Konkurrimi për ngritjen në detyrë është i mbyllur dhe në të kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm nëpunësit civil ekzistues të një kategorie më të ulët të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil. Neni 53 ka paraparë se: Për të aplikuar për ngritjen në detyrë, personi duhet të plotësojë së bashku, kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurohet. 2.Kushtet për ngritjen në detyrë janë: 2.1. nëpunësi të ketë të paktën tre (3) vjet pune në pozitën e një kategorie më të ulët. Në rastin e procedurës për ngritjen në detyrë në një pozitë të kategorisë të ulët drejtuese, periudha e punës provuese llogaritet si kohë e përvojës në punë; 2.2. nëpunësi të mos jetë ndëshkuar me masën disiplinore të parashikuar nga nën paragrafi 1.3 i neni 47 të Ligjit, që nuk është shuar ende; 2.3. nëpunësi të jetë vlerësuar të paktën "mire" për rezultatet individuale në punë, gjatë dy (2) viteve të fundit para konkurrimit për ngritje në detyrë. 3.Në rastin e vlerësimit të rezultateve individuale "shumë mirë" apo shkelqyeshem për dy vitet e fundit, nëpunësi mund të aplikojë për ngritje në detyrë edhe nëse ka vetëm dy (2) vite punë në kategorinë më të ulët. 4.Kërkesat e veçanta për pozitën e lirë përcaktohen sipas përshkrimit të punës dhe bëhen pjesë e shpalljes për ngritjen në detyrë.*

Rregulloren (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil- Neni 4 përcakton se: *Kategoritë e pozitave në shërbimin civil 1. Në pajtim me Ligjin, pozitat e punës në shërbimin civil të Kosovës ndahen në këto kategori funksionale: 1.1. Kategoria e Lartë Drejtuese; 1.2. Kategoria e Mesme Drejtuese; 1.3. Kategoria e Ulët Drejtuese, dhe 1.4. Kategoria Profesionale., ndërlidhur me këtë Neni 12 i kësaj rregullore ka paraparë se : Drejtues i Ulët 2 1. Udhëheqës i Divizionit në një Agjenci Ekzekutive; 2. Udhëheqës i Sektorit në një Komunë, ndërsa Shtojca Nr.1/7: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Drejtues i Ulët 2 ka përcaktuar se Kërkesat e Përgjithshme Formale lidhur me këtë kategori janë: a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. b) Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, Licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase. c) Përvoja e punës e kërkuar: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale.*

Andaj, Kolegji bazuar në provat e administruara ka konstatuar se kriteret për ngritje në detyrë si dhe kriteret e përgjithshme formale lidhur me pozitën e shpallur janë në pajtim me dispozitat ligjore të përshkruara si me lartë, e mbi këtë baze Kolegji ka analizuar dokumentacionin e aplikimit të kandidatës së përzgjedhur dhe ankueses dhe rrjedhimisht ka gjetur së të njëjtat kanë plotësuar kriteret për ngritje në detyrë dhe kriteret e përgjithshme formale, mirëpo bazuar në vlerësimet e testit me shkrim , jetëshkrimit dhe intervistës me gojë kandidatja ka fituar gjithsej 81.34 pikë duke u renditur si kandidatja me më shumë pikë, ndërsa ankuesja ka arritur gjithsej 79.66 pikë duke u renditur si kandidatja e dytë, kështu që mbi këtë bazë rrjedhë së Njësia e Burimeve Njerëzore ka vepruar në pajtim me nenin 44 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës më të cilin është përcaktuar se: *" Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurrimi..."*

Lidhur me pretendimin ankimor së Komisioni i Vlerësimit nuk ka qenë në pajtim me dispozitat ligjore, Kolegji ka analizuar Vendimin me numër 114/2022 të datës 15.07.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Sprovues të Kosovës, nga dhe ka vlerësuar së përbërja e Komisionit ka qenë në pajtim me nenin 59 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që pretendimi ankimor mbi këtë bazë është i paqëndrueshëm.

Përkitazi me pretendimin e ankueses së Komisioni i Vlerësimit nuk ka njoftuar kandidatët lidhu me çdo fazë të vlerësimit ashtu që kandidatet të kenë mundësi ankimimi, Kolegji duke u bazuar në nenin 56 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës konstaton se procedura e ngritjes në detyrë përbehet prej dy fazave dhe atë fazës së verifikimit paraprak dhe fazës së vlerësimit rrjedhimisht faza e vlerësimit përfshinë testimin me shkrim, jetëshkrimin dhe intervistën më gojë. Ndërlidhur me këtë e drejta e ankesës është e rregulluar me nenin 31 të kësaj rregullore më të cilin është përcaktuar se: "...3. Në rastin e pakënaqësisë ndaj procedurës apo rezultatit të konkurimit, pavarësisht nga faza me të cilin kandidati është i pakënaqur, ankesa parashtrohet ndaj aktit të përfundimit të procedurës të konkurimit sipas nenit 25 të kësaj Rregulloreje. 4. Ankesa ndaj aktit të përfundimit të procedurës të konkurimit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, mund të paraqitet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës. Procedura e brendshme e ankesës, vlerësohet së është shteruar nëse: 4.1. kandidati i pakënaqur me rezultatet e verifikimit paraprak ka parashtruar ankesën e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 15 të kësaj rregulloreje; 4.2. kandidati i pakënaqur me rezultatet e vlerësimit përfundimtar, ka parashtruar ankesën e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 25 të kësaj rregulloreje, apo 4.3. kandidati është cënuar drejtpërdrejtë nga aktet me të cilat është zgjidhur ankesa e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 15, sipas paragrafit 6 të nenit 25 e më sipër, të kësaj Rregulloreje" e mbi këtë bazë ligjore rrjedhë së kandidati në një procedure konkurim ka të drejtën e ankimit pas përfundimit të çdo faze, kështu që pretendimi ankimor në këtë kuptim është i pa bazuar.

Përkitazi me pretendimin ankimore të ankueses së vlerësimi i jetëshkrimit dhe intervistës me gojë nuk është profesional dhe etik, Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e lëndës nuk ka gjetur dëshmi për të provuar këtë pretendim ankimor të ankueses.

Theksuar si me sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit të shkresave të lëndës dhe duke qenë së nuk janë konstatuar shkelje procedurale gjatë zhvillimit të procedurës së konkurimit ngritje (avancim) në detyrë me numër reference RN00009138 për pozitën "Udhëheqës i Zyrës Regjionale 1", në Shërbimin Sprovues të Kosovës, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A .nr.775/2022.

Aydyll Bekteshi

Procesmbajtës



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Sprovues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Sprovues të Kosovës
- Arkivit të KPMSHCK- së.